



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.08.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. AKK-DPKI-01/19/056, për zyrtarin e lartë z. Burim Kelmendi, Kryeshef Ekzekutiv në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Pastrimi" sh.a. Prishtinë, për shkak së është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtutjeshëm: Agjencia) ka shqyrtuar rastin për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-DPKI-01/19/056, lidhur me zyrtarin e lartë z. Burim Kelmendi, Kryeshef Ekzekutiv në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Pastrimi" sh.a. - Prishtinë, duke zhvilluar procedurën e paraparë sipas Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar rastin e konfliktit të interesit, sipas të cilit z. Burim Kelmendi, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, respektivisht Kryeshef Ekzekutiv në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Pastrimi" sh.a. - Prishtinë, i njëjti figuronte si Përfaqësues i Autorizuar në biznesin privat "Pelikan Kosova" O.P. Përmes shkresës zyrtare, Agjencia fillimisht ka kërkuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (në tekstin e mëtutjeshëm: ARBK), verifikimin dhe konfirmimin e informacionit lidhur me biznesin e cituar mësipër. Nga përgjigja e ARBK-së (shkresa zyrtare nr. DPKI-06-2337-1/19), rezulton se zyrtari i lartë z. Burim Kelmendi është Përfaqësues i Autorizuar në biznesin në fjalë.

Me rastin e konfirmimit të informacionit të mësipërm, në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Agjencia përmes shkresës zyrtare AKK-DPKI-01/19/056, e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Burim Kelmendi për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Pas pranimit të kësaj shkrese nga zyrtari i lartë, është organizuar dhe mbajtur një takim brenda Agjencisë, ku i njëjti është njoftuar gjerësisht lidhur me faktin se, gjatë ushtrimit të funksionit në cilësinë e zyrtarit të lartë publik, ai nuk mundet që njëkohësisht të jetë edhe Përfaqësues i Autorizuar në biznesin privat, sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, dhe si e tillë bie ndesh me nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, ku përcaktohet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i Personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.

Pas diskutimit dhe ballafaqimit të fakteve, zyrtari i lartë z. Burim Kelmendi është pajtuar me gjetjet e Agjencisë, duke deklaruar se do të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik. Në vijim, pala ka deklaruar se ai edhe më parë ka bërë përpjekje të vazhdueshme që të kontaktojë dy (bashkë) pronarët e biznesit në fjalë, shtetas nga Republika e Shqipërisë, në mënyrë që të lirohet edhe formalisht nga cilësia e Përfaqësuesit të Autorizuar, por vendosja e çfarëdo kontakti apo komunikimi me pronarët e biznesit në fjalë, ka qenë i pamundur, pasi që ata (pronarët/aksionarët), sipas palës, ka vite që nuk operojnë në Kosovë.

Në takim, Agjencia ka kërkuar nga pala që të vazhdoj përpjekjet e tij për të vendosur kontakt me (bashkë) pronarët e biznesit në fjalë, si dhe ndërkohë, situatën e përshkruar nga ai në takim rreth pamundësinë së tërheqjes së tij nga cilësia e Përfaqësuesit të Autorizuar në biznes, ta paraqes edhe në formë të deklaratës së shkruar (përmes aktit noterial) dhe të njëjtën t’ia dërgoj Agjencisë kundër Korrupsion, veprim të cilin pala e ka bërë pa vonesë përmes shkresës zyrtare DPKI-06-2516-1/19.

Përmes deklaratës (aktit noterial), pala ka deklaruar se, *“Heq dorë si Përfaqësues i autorizuar nga biznesi “Pelikan Kosova O.P.” [...], pasi që nga i njëjti biznes dhe të njëjtit pronar/aksionar nuk kam asnjë përfitim apo të mira materiale tjera dhe se biznesi me të dhënat si më lartë nuk ka ushtruar aktivitet asnjëherë”.* Gjithashtu në vazhdim pala ka deklaruar se: *“[...] tërhiqem si Përfaqësues i Autorizuar i biznesit si më lartë, pasi që tani jam i angazhuar në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv në Kompaninë Rajonale për Mbeturina “Pastrimi” Sh. A. në Prishtinë”.*

Në vazhden e veprimeve të ndërmarra lidhur me rastin në fjalë, janë realizuar takime dhe komunikime të vazhdueshme me palën, me ç’rast Agjencia është njoftuar me të gjitha veprimet konkrete që pala ka ndërmarrë në drejtim të vendosjes së kontaktit me pronarët e biznesit në fjalë, në mënyrë që të bëhet i mundur ndryshimi i Përfaqësuesit të Autorizuar konform dispozitave përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, por sipas palës, një gjë e tillë ka qenë dhe vazhdon të mbetet e pamundur.



Nën këto rrethana, është vënë në zbatim dispozita e nenit 24, paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, e cili përcakton që: “[...] Për të regjistruar Përfaqësuesin e Autorizuar, kërkohet pëlqimi i tij apo saj me shkrim. Organi kompetent i Shoqërisë Tregtare për emërimin e Përfaqësuesit të Autorizuar mundet që në çdo kohë, pa marrë parasysh arsyen, të ndërpresë autorizimet e Përfaqësuesit të Autorizuar si dhe të bëjë ndryshimet përkatëse në Regjistër. Në rast të dorëheqjes nga Përfaqësuesi i Autorizuar nga kjo pozitë, Përfaqësuesi i Autorizuar mund të kërkojë nga ARBK për të bërë ndryshimet përkatëse në Regjistër, nëse dorëzon në ARBK dokumentin e dorëheqjes dhe dëshminë që ka njoftuar organin kompetent të Shoqërisë Tregtare për dorëheqjen”.

Në pajtim me kërkesat e dispozitës së sipërcituar, Agjencia ka kërkuar nga pala kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe më pas dorëzimin dhe aplikimin në ARBK, në mënyrë që kjo e fundit të bëjë ndryshimin e Përfaqësuesit të Autorizuar sipas ligjit dhe statutit. Në ndjekje të kësaj procedure, pala ka kompletuar gjithë dokumentacionin e kërkuar dhe të njëjtin e ka dorëzuar në ARBK.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar nga ARBK shkresën zyrtare DPKI-06-1727/20, me të cilën dëshmohet se konform dispozitës së nenit 24, paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare, janë bërë ndryshimet e kërkuara për zyrtarin e lartë z. Burim Kelmendi dhe i njëjti nuk figuron më të jetë Përfaqësues i Autorizuar në biznesin privat “Pelikan Kosova” O.P.

Prandaj, me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Burim Kelmendi, Kryeshef Ekzekutiv në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave “Pastrimi” sh.a. - Prishtinë, si dhe ndryshimet e bëra mëpas sipas ligjit dhe statutit nga ARBK, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë. Prandaj, në bazë të asaj që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik,
- Drejtorit të DPKI-së,
- Zyrtarit përgjegjës.

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

